

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit B. R. nga Gjakova, për shkak të veprës penale: lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, me numër PP.nr.925/2016, të datës 18.11.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 26.04.2017, në prezencën e Prokurorit të shtetit Bajram Kryeziu, të dëmtuarve D. Z. dhe G. B. si dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M**I akuzuari:**

B. R., nga i ati G., e ëma N., e gjinisë B., i lindur me datën... në Gjakovë, i martuar baba i 2 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punon si kuzhinier në “P. K.” në Gjakovë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 14.06.2015, rreth orës 22.20 minuta, në Gjakovë në rrugën “A. T.” p.n, në lokalit të tij “The D. B.”, pas një mosmarrëveshje lidhur me ngacmimin e klientëve fillimisht e tërheq për maic të dëmtuarin D. e më pas e sulmon fizikisht duke e goditur me grusht fytyrës, e derisa ndërhyjnë të i ndajë i dëmtuari G. e sulmon dhe atë fizikisht dhe e godet me grusht fytyrës, e të dëmtuarve: D. (F.)Z. nga Gjakova me banim në rrugën “S.R.” dhe G.(T.) B. nga Gjakova me banim në rrugën “I. E.”, u shkakton lëndime të lehta trupore të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të Dr. D. H. i datës 03.11.2016.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: lëndimi i lehta trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par. 1, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73 nenit 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

D Ë N I M I N M E K U S H T

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari, që ti paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë: për ekspertizën mjeko-ligjore shumë prej 20 Euro si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumë prej 40 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën, PP.nr. 925/2016, të datës 18.11.2016, kundër të akuzuarit B. R. nga Gjakova, për shkak të veprës penale: lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së. Gjatë shqyrtimit fillestar Prokurori i Shtetit Bajram Kryeziu ka bërë përmirësimin e dispozitivit të aktakuzës dhe përmirësimin e kualifikimit juridik në aktakuzë duke deklaruar se gjatë leximit vërejtja se në rreshtin e katërt është bërë një gabim teknik dhe atë ku është konstatuar “ndaj të dëmtuarit G.” e që në fakt duhet të jetë “ndaj të dëmtuarit G.” andaj bëjë përmirësimin e dispozitivit të akuzës në këtë pjesë ashtu që ku është shënuar “G.” duhet të jetë “G.” po ashtu bëjë përmirësimin e kualifikimit juridik të veprës penale ashtu që kualifikimit juridik duhet ti shtohet nënpar.1.4 i nenit 188 par. 1 të KPRK-së ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pa ndryshuar. Prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit B. R. andaj, ka propozuar që i njëjti të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari B. R., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohet dhe ka shtuar se i vijën keq për rastin që ka ndodhë, me të dëmtuarit është pajtuar, nuk ka asgjë të keqe në mes tyre dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla.

Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu, duke dhënë mendimin rreth pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit, ka deklaruar se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e bën me vetëdije dhe vullnet të plotë pa presion, i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë po ashtu pranimi i fajësisë mbështetet edhe provat dhe në faktet që janë bashkëngjitur aktakuzës.

I dëmtuari D. Z. duke dhënë mendimin rreth pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit, ka deklaruar se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit por si i dëmtuar në këtë rast nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale dhe nuk kërkojë që i njëjti të dënohet meqenëse jemi pajtuar me të akuzuarin dhe nuk kemi asgjë të keqe dhe si palë e dëmtuar nuk parashtroi kërkesë pasurore-juridike dhe nuk kërkoj nga i akuzuari që të ma kompensoi dëmin për lëndimet e marra.

I dëmtuari G. B. duke dhënë mendimin rreth pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit, ka deklaruar se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit por si i dëmtuar në këtë rast nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale dhe nuk kërkojë që i njëjti të dënohet meqenëse jemi pajtuar me të akuzuarin dhe nuk kemi asgjë të keqe dhe si palë e dëmtuar nuk parashtroi kërkesë pasurore-juridike dhe nuk kërkoj nga i akuzuari që të ma kompensoi dëmin për lëndimet e marra.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi është vërtetuar se i akuzuari B. R., me datë 14.06.2015, rreth orës 22.20 minuta, në Gjakovë në rrugën “A. T.”, në lokalit e tij “T. D. B.”, pas një mosmarrëveshje lidhur me ngacmimin e klientëve fillimisht e tërheq për maic të dëmtuarin D. e më pas e sulmon fizikisht duke e goditur me grusht fytyrës, e derisa ndërhyjnë të i ndajë i dëmtuari G. e sulmon dhe atë fizikisht dhe e godet me grusht fytyrës, e të dëmtuarve: D. (F.)Z. nga Gjakova me banim në rrugën “S. R.” dhe G. (T.) B. nga Gjakova me banim në rrugën “I. E.”, u shkakton lëndime të lehta trupore të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të Dr. D. H. i datës 03.11.2016.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimin të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues

konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e paraparë në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarës gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit dhe atë: se është baba i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, është mbajtës i familjes pesë anëtarësh, në gjykim ka patuar qëndrim tejet korrekt, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale do të jetë më i kujdesshëm, faktin se me të dëmtuarit është pajtuar, të dëmtuarit nuk i bashkëngjiten ndjekjes penale dhe nuk parashtruan kërkesë pasurore-juridike si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar, ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se dënimin me kusht, duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Gjykata nuk i udhëzoi të dëmtuarit D. Z. dhe G. B. në kontest të rregullt juridiko-civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, pasi që gjatë shqyrtimit fillestar që të dy kanë deklaruar se si palë të dëmtuara nuk parashtrojnë kërkesë pasurore-juridike meqenëse me të akuzuarin janë pajtuar dhe nuk kërkojnë nga i akuzuari që t'iu kompensoi dëmin për lëndimet e marra.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe mbi shpenzimet e paushallit gjyqësorë është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPP-së

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr. 724/16, me datë 26.04.2017

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mentor Bajraktari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.